

## DHUNA NË FAMILJE NË KOSOVË

**FOLËSI:** Dhuna kundër gruas është problem serioz që ekziston në të gjithë botën. Kosova nuk përbën përjashtim në këtë drejtim. Në një studim të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në vitin 2008, 48 përqind e femrave në Kosovë kanë thënë se është në rregull që burrat e tyre t'i godasin ato. Disa qëndrime mund të kenë ndryshuar që atëherë, mirëpo, gjendja aktuale është shumë larg nga ajo e përkryer.

Strehimorja e grave Liria, në qytetin e Gjilanit, u themelua në vitin 1999. Kjo qendër përkujdeset për gratë që kanë vuajtur nga dhuna në familje. Gratë e strehuara aty vijnë nga dhjetë komuna të ndryshme. Ato janë nën kujdesin e psikologëve dhe punëtorëve social. Strehimorja Liria përkrahet nga pesë agjencione të Kombeve të Bashkuara.

Nazife Jonuzi, themeluese dhe udhëheqëse e strehimores Liria, thotë se shoqëria kosovare ka bërë një rrugë të gjatë përpara.

**NAZIFE JONUZI:** Që nga viti 1999 janë bërë shumë hapa përpara. Nuk është më tabu se gratë dalin dhe e denoncojnë dhunën. Ne kemi mbajtur edhe puntori nëpër fshatra për t'i informuar gratë për punën që e bëjmë ne. Kanë thënë se gratë e pamoralshme dhe gratë a papërgjegjshme rrinë në këtë shtëpi. Mirëpo, kanë kaluar shumë vite dhe tash e shohin me një sy krejt tjetër, për shkak se tash ka shumë ndryshime në familje dhe shoqëri.

**FOLËSI:** Shumica e grave në strehimoren Liria kanë përfunduar aty sepse nuk kanë ku të shkojnë tjetër. Njëra nga të mbijetuarat thotë se burri i saj e kishte rrahur deri në atë masë sa e kishte kuptuar se duhej të largohej.

**E MBIJETUARA:** Mu më ka rrahur. Nganjëherë më ka nxjerrë nga krevati, vetëm se kishte dëshirë të bënte ashtu, me këpucë më goditke në bark. Fëmijët ishin aty kur më ka rrahur. Me detyronte të hy në vaske me ujë të ftohte, provonte të mi nxirrte sytë dhe vetëm e kam hapur dritaren dhe kam bërë titur, sepse kam pas gjakëderdhje. Kam kërkuar ndihmë nga fqinjët. Kam thënë më ndihmoni se do të vdes.

**FOLËSI:** E mbijetuara e gjeti rrugën deri te strehimorja, por meqë ishte e papunë, gjykata vendosi që burri i saj do të përkujdesej për pesë fëmijët e tyre.

**E MBIJETUARA:** Qe dy vjet nuk jam me fëmijët e mi. Më kërkojnë gjëra për të ngrënë. Më thojnë fëmijët Oh nënë, na ka marrë malli me ngrënë gjërat që i bënë ti. Nuk di çfarë të bëjë.

**FOLËSI:** Sipas strehimores Liria, të mbijetuarëve iu duhet pavarësi ekonomike.

**NAZIFE JONUZI:** Të gjitha institucionet kanë punuar pak në parandalim/mbrojtje, mirëpo sa i përket integritit për viktimat e dhunës është zero. 90 përqind të grave që kanë kaluar nëpër strehimore kthehen në ambiente të dhunës. Pse? - nuk ka punësim të qëndrueshëm.

**FOLËSI:** Aktorët vendas dhe ata nderkombëtarë janë duke punuar për të adresuar këtë problem. Igballe Hajdari është disajnere e veshjeve në Gjilan. Ajo i trajnon dhe i punëson të mbijetuarit.

**IGBALLE HAJDARI:** I Kam parë që ato janë këtu për shkak të dhunës që e kanë përjetuar. I kam marrë dhe iu kam mbajtur kurse për artizanate. Kanë punuar me materiale të mia dhe në tash po i trajnojmë me një kurs të rrobaqepsisë. Unë tash po e shoh që ato kanë vullnet për të punuar.

**FOLËSI:** Ekipi i Kombeve të Bashkuara përpiqet të ndihmojë. Me mbështetjen e Kombeve të Bashkuara, Kosova është bërë një nga vendet e pakta në rajon që ka një ligj kundër dhunës në familje. Andrew Russell është Koordinator i Fondit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara.

**ANDREW RUSSELL:** Ligjet janë të rëndësishme, por gjithashtu duhet të shohim ndryshime të vërteta në terren. Për këtë arsye, Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë është në partneritet me institucionet lokale për të krijuar sisteme afatgjate dhe kapacitete për trajtimin e të gjitha aspekteve të dhunës gjinore dhe, posaçërisht, dhunës në familje ashtu që të kemi ligje të mira jo vetëm në letër por edhe t i zbatojmë ato. Ne kemi ndihmuar jo vetëm në themelimin e strehimoreve për të mbijetuarat e dhunës, por edhe kemi advokuar për qëndrueshmërinë afatgjate financiare të tyre. Poashtu kemi ndihmuar në fuqizimin e kapaciteteve hetimore për t u ballafaquar me rastet individuale. Për shembull, kemi ndihmuar në krijimin e hapësirave të sigurta intervistuese ku gratë dhe fëmijët mund të ndihen rehatshëm për të raportuar abuzimet. Dhe, ndoshta edhe më me rëndësi, duke punuar me partnerët tanë lokalë, OKB-ja ka shfrytëzuar kapacitetet e veta për të parë se si mund t i lidhim të mbijetuarat e dhunës në familje me punësim afatgjatë. Kështu që, përfundimisht, të mund të zhvendosen prej strehimoreve dhe të bëhen financiarisht të pavarura.

**FOLËSI:** Dhuna kundër grave është ende një nga shkeljet e të drejtave të njeriut më të perhapura në botë. Kjo i prek femrat e të gjitha moshave, grupeve etnike, dhe prapavijave sociale. Kjo ndodhë në kohën e paqes si dhe gjatë kohës së konfliktit. Dhe vetëm duke u bashkuar mund të shpresojmë të eliminojmë këtë pandemi globale.